



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 1386/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit "Meditech" Sh.p.k., me seli në Graçanicë, me numër unik identifikues 810828270, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "RPHS Law", me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, rr. "Migjeni", për shkak të anulimit të vendimit PSH. nr. 397, 409/22 të datës 11.10.2022 i nxjerrë nga OSHP dhe kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, jashtë seancës, më datë 14.12.2022 merr këtë:


AKT V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit "Meditech" Sh.p.k., me të cilin ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit PSH. nr. 397, 409/22 të datës 11.10.2022, të nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit.

A r s y e t i m

Paditësi "Meditech" Sh.p.k., me seli në Graçanicë, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, pranë kësaj gjykate ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit PSH.nr.397, 409/22 të datës 11.10.2022 të nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit PSH.nr.397, 409/22 të datës 11.10.2022 deri në vendimin përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë.

Paditësi, në kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit lidhur me plotësimin e kushteve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit ka theksuar se të njëjtit i shkaktohet dëm material për shkak se i njëjti për vite me radhë ka regjistruar produktet e tij mjekësore në Kosovë me autorizim marketingu, në mënyrë që të siguroj kualitetin dhe origjinën e produkteve mjekësore dhe marrë parasysh që ky proces ka qenë i kushtueshëm paditësit i ka ndikuar shumë financiarisht. Paditësi po ashtu ka theksuar se shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik, përkundrazi e njëjta i shërben atij sepse importi i barnave kualitative dhe të sigurta garantohet vetëm me autorizim nga Autorizimi Marketingu



që lëshohet nga ana e AKPPM-së. Në rastin konkret nëse do të blihen barna të paregjistruara atëherë këto barna do të kishin efekte anësore tek pacientët me diabet. Krejt në fund ka theksuar se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk do të sillte asnjë dëm për palën kundërshtare apo palët e treta, përkundrazi kjo shtyrje do ti ndihmonte palës kundërshtare në rivendosjen e ligjshmërisë së vendimeve të saj, sepse ngjashëm sikurse ka vepruar me rastin e paditësit, ky organ do të mund të veprojë edhe me dhjetëra apo qindra raste të ngjashme duke iu shkaktuar pasoja të mëdha.

Me qëllim të vlerësimit të këtij propozimi, gjykata ju referua nenit 22, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: *“Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”*. Po ashtu në paragrafin 6 përcaktohet se *“Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”*.

Bazuar në nenin 22 par. 2 të LKA-së, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara: a) ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej; b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik; c) shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Gjykata shqyrtoi pretendimet e paditësit të paraqitura në propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe vlerësoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që pretendimet e paraqitura në kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimi nuk kanë mbështetje ligjore si dhe nuk është argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit të paraqitura në kërkesë lidhur me dëmin që do ti shkaktonte në rast se nuk shtyhet ekzekutimi i vendimit nuk janë të bazuara pasi që në këtë rast i paditur ka aprovuar ankesën e operatorit ekonomik “Pharma Leader” L.L.C. dhe ka kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim tek autoriteti kontraktues ndërsa ankesën e



paditësit e ka refuzuar si të palejuar, andaj në këtë rast nuk do të ketë asnjë dëm për paditësin pasi që i gjithë aktiviteti i prokurimit është kthyer në rivlerësim tek autoriteti kontraktues.

Gjykata po ashtu i vlerësoi si të pabazuara edhe pretendimet e paditësit se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare pasi që gjykata vlerëson se në këtë rast interesi publik është që të përfundohet procedura për furnizim me produkte medicinale nga lista esenciale, ndërsa shtyrja e ekzekutimit të vendimit, do ta pezullonte këtë çështje deri në vendosjen nga gjykata. Gjithashtu gjykata vlerëson si të paqëndrueshëm argumentin e paditësit se autoriteti kontraktues nuk do mbetej pa furnizim pasi që mund të bënte blerje urgjente apo furnizim përmes partnerëve ndërkombëtarë.

Krejt në fund, gjykata vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të vendimit personave të interesuar do të ju sillte dëm të madh pasi që autoriteti kontraktues do mbetej pa furnizim me insulinë deri në vendosjen përfundimtare nga gjykata.

Prandaj, gjykata në këtë rast vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet për aprovimin e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, ndërsa lidhur me pretendimet tjera të paraqitura në padi, gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave të propozuara dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë, por që këto pretendime dhe prova nuk janë me ndikim me rastin e vlerësimit të besueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 22 par. 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS


Dhomat e Shkallës së Parë,

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.1386/22, datë 14.12.2022

Gjyqtari

Arnis Dumanj



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.